



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 29.6.2021

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR AKTIN NORMATIV NR.25, DATË 22.6.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9936, DATË 26.6.2008, “PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 29 qershor 2021, shqyrtoi aktin normativ nr.25, datë 22.6.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,. Akti normativ u shqyrtua sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë akt normativ, z. Anastas Angjeli.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Anila Denaj, Ministre;
- Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit;
- Znj. Xhoana Agolli, Drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit;
- Z. Gentian Opre, Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor.

II. Baza ligjore.

Akti normativ nr.25, datë 22.6.2021 është paraqitur për miratim nga Këshilli i Ministrave në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës, sipas

kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi i tij kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ.

Akti normativ nr.25, datë 22.6.2021 ka qëllim ofrimin e stimuljeve të nevojshëm fiskalë në kahun e shpenzimeve buxhetore, në kuadër të rimëkëmbjes së ekonomisë së vendit, pas dy goditjeve të njëpasnjëshme të saj, tërmetit të datës 26 nëntor 2019 dhe pandemisë shëndetësore COVID-19.

- *Nevoja për aktin normativ.*

Akti normativ nr.25, datë 22.6.2021 u bë i nevojshëm pas rishikimit të buxhetit të vitit 2021 me aktin normativ nr.26, datë 22.6.2021 dhe vjen si paketë ligjore së bashku me të. Rishikimi i buxhetit ka qëllim ofrimin e stimuljeve fiskalë në kahun e shpenzimeve buxhetore, për të nxitur rimëkëmbjen e ekonomisë, duke rritur nivelin e defiçitit buxhetor dhe borxhit publik tej atij të përcaktuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor. Kjo bëri në nevojshëm harmonizimin e ligjit të buxhetit të vitit 2021 me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor.

- *Përmbajtja e aktit normativ.*

Akti normativ nr.25 datë 22.6.2021 parashikon dy ndryshime kryesore në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, si më poshtë:

- ***Së pari***, parimet dhe rregullat fiskale, të përcaktuara në pikat 1-4 të nenit 4/1 të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, të mos aplikohen përjashtimisht për vitin 2021. Ky ndryshim synon t'i ofrojë buxhetit të shtetit fleksibilitetin e domosdoshëm, si instrument kryesor stabilizues dhe nxitës të rritjes ekonomike.
- ***Së dyti***, afati për fillimin e zbatimit të rregullit fiskal, të përcaktuar në pikën 5 të nenit 4/1, të shtyhet nga viti 2023, në vitin 2024. Ky ndryshim synon që detyrimi për balancën primare buxhetore pozitive të fillojë nga viti 2024 dhe jo nga viti 2023, siç përcaktohet në ligjin aktual. Qëllimi i këtij ndryshimi është forcimi i kredibilitetit të qëndrueshmërisë së financave publike.

- *Argumentimi i synimeve të aktit normativ.*

Synimi I. Ofrimi i fleksibilitetit të domosdoshëm buxhetit të shtetit, si instrument kryesor stabilizues dhe nxitës i rritjes ekonomike.

Rregullat fiskale, të përcaktuara në pikat 1-4 të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, përcaktojnë detyrimin për uljen graduale, në ligjet vjetore të buxhetit, të borxhit publik, deri sa niveli i tij të arrijë 45 për qind të PBB.

Pas analizës së situatës aktuale makroekonomike dhe të pritshmërive të saj për vitin 2021, si dhe për periudhën afatmesme 2022-2024, Këshilli i Ministrave vlerësoi se është i nevojshëm një stimul i mëtejshëm fiskal në kahun e shpenzimeve buxhetore, për të nxitur rritjen ekonomike në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Përshpejtimi i ritmeve të rritjes ekonomike do të ndikojë në rritjen e punësimit dhe të mirëqenies ekonomike për qytetarët, si dhe ofrimin e një game më të gjerë shërbimesh publike. Gjithashtu, ai do të ndikojë në reduktimin më të shpejtë të borxhit publik.

Ky vlerësim është në përputhje me udhëzimet fiskale të Komisionit European për vendet e BE, datë 2 qershor 2021. Këto udhëzime shtrijnë aplikimin e klauzolës së përgjithshme përjashtuese për politikën fiskale të vendeve të BE edhe përgjatë vitit 2022. Komisioni European argumenton se politika fiskale zgjeruese, e cila do të lejohet gjatë periudhës 2021-2022 për vendet e BE, synon implementimin e investimeve të reja publike dhe reformave të nevojshme strukturore, që do të mbështesin rimëkëmbjen ekonomike, forcimin e potencialit të rritjes ekonomike dhe punësimit, si dhe përmirësimin e financave publike.

Mbështetur në këto politika, akti normativ për rishikimin e buxhetit të vitit 2021 parashikon këto ndryshime kryesore në treguesit makroekonomikë e fiskalë:

- Shpenzimet kapitale rriten me rreth 7.7 për qind të PBB (përfshirë rindërtimin);
- Deficiti buxhetor rritet me 0.6 për qind të PBB;
- Borxhi publik rritet nga 76.1 për qind e PBB në vitin 2020, në 80 për qind të PBB në vitin 2021 (përfshirë edhe garancitë e reja të huamarrjes së sektorit elektroenergjitik).

Këto ndryshime bënë të nevojshëm që, për vitin 2021, të mos zbatohen rregullat fiskale të përcaktuara në pikat 1-4 të nenit 4/1 të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Synimi II. Forcimi i kredibilitetit të qëndrueshmërisë së financave publike.

Gjatë periudhës 2016-2019 financat publike kanë ndjekur trajektoren e konsolidimit fiskal, e cila vërehet në treguesit kryesorë, si më poshtë:

- Balanca primare ishte pozitive;

- Deficiti buxhetor u reduktua nga mesatarisht 4.4 për qind e PBB në vitet 2012-2015, në 1.8 për qind të PBB në vitin 2019;
- Borxhi publik u reduktua nga 72.7 për qind e PBB në vitin 2015, në 66.3 për qind e PBB në vitin 2019.

Pas dy goditjeve që pësoi ekonomia e vendit, tërmetit të datës 26 nëntor 2019 dhe veçanërisht pandemisë shëndetësore COVID-19, e cila ishte me ndikim më të madh, politika ekonomike u tërhoq përkohësisht nga objektivi i konsolidimit fiskal. Kjo politikë kishte prioritet financimin e procesit të rindërtimit të vendit dhe mbështetjen e shtresave të goditura nga fatkeqësitë natyrore.

Si rrjedhojë, treguesit makroekonomikë të vitit 2020 u përkeqësuan, duke arritur nivelet si më poshtë:

- Rritja ekonomike në vitin 2020 ishte negative (-3.3) për qind;
- Borxhi publik ishte 76.1 për qind e PBB (nga 66.3 për qind e PBB në vitin 2019).

Në periudhën afatmesme 2022-2024, dhe aq më tepër në periudhën afatgjatë, politikat fiskale pritet t'i rikthehen konsolidimit fiskal, për të arritur stabilitetin makroekonomik të vendit dhe rritjen e ekonomisë. Si rrjedhojë, rregullat fiskale të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor do të përbëjnë objektivin kryesor të politikës fiskale. Ulja e vazhdueshme e borxhit publik, deri sa ai të zbrësë poshtë nivelit prej 45 për qind të PBB, do të vijojë të jetë objektivi kryesor i politikës fiskale. Për këtë arsye, objektivat realë të konsolidimit fiskal në periudhën afatmesme duhet të pasqyrohen në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e kredibilitetit të qëndrueshmërisë së financave publike.

IV. Paraqitja e ndryshimeve me akt normativ.

Rishikimi i ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor vjen si paketë e përbashkët me rishikimin e buxhetit të vitit 2021. Ndryshimet në buxhetin e vitit 2021 mundësojnë financimin e procesit të vaksinimit masiv të popullsisë dhe realizimin e disa projekteve prioritare të ekonomisë. Këto ndryshime bëjnë të nevojshme ndryshimet në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, duke harmonizuar legjislacionin. Të dy këto akte plotësojnë kërkesat e nevojës, urgjencës dhe të përkohshmërisë, të përcaktuara në nenin 101 të kushtetutës.

V. Diskutimi në Komision.

Znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, paraqiti projektligjin, duke argumentuar domosdoshmërinë dhe rëndësinë e miratimit të tij, si dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Z. Anastas Angjeli, në cilësinë e relatorit, theksoi se akti normativ nr.25, datë 22.6.2021 është i domosdoshëm, pasi mundëson harmonizimin e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor me ligjin për buxhetin e vitit 2021, duke pasqyruar situatën aktuale dhe atë të pritshme të zhvillimit ekonomik të vendit. Ky akt normativ do të krijojë fleksibilitetin e nevojshëm për përdorimin e buxhetit të shtetit si instrument për nxitjen e zhvillimit ekonomik të vendit dhe forcimin e kredibilitetit të qëndrueshmërisë së financave publike.

Gjatë diskutimit projektligji u mbështet nga shumica e deputetëve.

VI. Përfundim.

Mbështetur në argumentet e citura më lart, Komisioni e miratoi aktin normativ nr.25, datë 22.6.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash.

KRYETARI

Anastas ANGJELI